



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJES
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

Nr. 1181 Prot.

Vau Dejes me 19.02.2024

NJOFTIM PËR DËGJESË PUBLIKE

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 18 pika 1 dhe pika 2 , neni 54 germa (e) dhe në Rregulloren e Brendshme për Funkcionimin e Këshillit Bashkiak Vau Dejës (VKB 23/2020) neni 154:

Këshilli Bashkiak Vau Dejës fton të gjithë banorët e fshatit Stajka, Njesia Administrative Bushat të bëjnë sugjerimet e tyre lidhur me projekt vendimin e mëposhtëm:

Projekt vendim për dhënien në përdorim të sipërfaqes pyjore prej 0.442 ha, për agropylltari, në ngastren nr.14 të ekonomisë pyjore Drin Gjader Kirë.

(Paraqitur nga Drejtoria e pyjeve, turizmit dhe mbrojtjes së mjedisit-sektori menaxhimit të pyjeve dhe kullotave)

Dëgjesa publike do të bëhet me datë **20.03.2024 ora 10.30 fshati Stajka**, Njësia Administrative Bushat.

Gjithashtu ju ftojmë të bëheni pjesë e dëgjesës për projekt vendimin e mësipërm,nëpërmjet sugjerimeve tuaja në adresat elektronike:

(info@vaudejes.gov.al , ardian.celepija@vaudejes.gov.al, facebook – Këshilli Bashkiak Vau Dejës).

SEKRETARI I KËSHILLIT

Ardian CELEPIJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJES
DREJTORIA E PYJEVE, TURIZMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE

PROJEKT VENDIM
Nr. 9, datë 15.02.2024

“Për dhënien në përdorim të sipërfaqes pyjore prej 0.442 ha, për Agropylltari, në ngastrën nr.14 të Ekonomisë Pyjore Drin Gjadër Kir”

Mbështetur në nenin 9 pika 1.2 germa “a”, nenit 27 pika 5, nenit 54 germa “e/l”, nenit 55 pika 3, nenit 18, neni 64 germa “c” të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; nenin 25 pika 1 germa “b” të ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020 “Për pyjet”; pikën 49, shtojca 47, të VKM-së nr. 433 datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, i ndryshuar; shtojcën nr.1, pika 5/1 të VKM-së nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”; Kreun II pika 3, Kreun III pika 6 të VKM-së nr. 748, datë 01.12.2022 “Për përcaktimin e zonës, distancës dhe gjerësisë së brigjeve të burimeve ujore”; VKB-në Vau Dejës nr. 07 dt.26.01.2024 Mbi miratimin e listës së ngastrave/ nënngastrave pyjore të gatshme për dhënie në përdorim” Udhëzimin nr. 1, datë 09.06.2016 të Ministrit të Mjedisit “Për Rregullat e procedurat e kërimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, ku në mbledhjen e datës _____ 2024 të:

V E N D O S I

1. Miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes pyjore prej 0.442 ha, **për Agropylltari**, në ngastrën nr.14 të Ekonomisë Pyjore Drin Gjadër Kir, sipas, hartës topografike, relacionit dhe raportit mbi studimin tekniko-ekonomik bashkëngjitur.
2. Afati i dhënies në përdorim të jetë deri në 9 (nëntë) vjet.
3. Vlera e dhënies me qira vjetore të jetë sipas VKM-së nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”, shtojca 1/5.
4. Për zbatimin e vendimit ngarkohet Kryetari i Bashkisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

5. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pika 6 të Ligjit nr .139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETARI
Kristian Shkreli

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZV/KRYETARI
Gjovanni Zefi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË PYJEVE, INSPEKTIMIT DHE MBROJTJES SE
MJEDISIT
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE

Nr. 14 prot.

Vau Dejës, më 15 . 02 .2024

RELACION

“Për dhënien në përdorim me afat deri në 9 vjet sipërfaqen pyjore prej 0.442 ha, për Agropylltari, në Ekonominë Pyjore Drin Gjadër Kir”

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Vau i Dejës

Të nderuar këshilltarë,

Administrimi i fondit pyjor dhe kullësor në territorin e Bashkisë Vau Dejës, është një ndër funksionet e Bashkisë, i përcaktuar në nenin 27 pika 5 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, përcaktohet:

“Funksionet e Bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit: Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve: pika 5. Administrimin e fondit pyjor dhe kullësor publik, sipas legjislacionit në fuqi.”

Ligji bazë mbi të cilin kryhet administrimi i fondit pyjor është ligji nr. 57/2020 “Për pyjet” i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Bazuar në nenin 9 pika 1.2 germa “a”, nenit 54 germa “e/l”, nenit 55 pika 3, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, është kompetencë e Këshillit të Bashkisë, dhënia me qira të tretëve të pronave të Bashkisë.

Sipërfaqja e fondit pyjor që kërkohet të jepet në përdorim është 0.442 ha. Kjo sipërfaqje do t’i nënshtrohet procedurës së konkurimit publik sipas legjislacionit në fuqi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Procedura e ndjekur është në zbatim të Udhëzimit nr. 1, datë 09.06.2016 të Ministrit të Mjedisit “Për Rregullat e procedurat e kërkimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik.”.

Në funksion të sipërfaqes që merret në përdorim, sipas VKM-së nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”, Shtojca 1, pika 5/1, si dhe bazohen në afatin kohor sipas grafikut të punimeve të miratuar nga institucioni përkatës dhe kategorinë e përdorimit si më poshtë:

5. Për agropylltari				
Nr.	Përdorimi i territorit	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit		
		1 vit	2-5 vjet	6-10 vjet
1	Tokë me bimësi pyjore, djerr	15000	13000	10000

Vlera totale e pagesës/vit sipas raportit teknik-ekonomik është 4,420 lekë në vit (katër mijë e katërqind e njëzet) lekë.

“Brigjet” janë rripat anësorë të tokës përgjatë rrjedhës së shtratit të lumit. Duke u mbështetur në Kreun III pika 6 germa “dh” e VKM-së nr. 748, datë 01.12.2022 “Për përcaktimin e zonës, distancës dhe gjerësisë së brigjeve të burimeve ujore”, që parashikon:

“dh) në lumenjtë e përrenjtë, shtretërit dhe/ose brigjet e të cilëve janë mbrojtur me argjinaturë dhe/ose strukturë gjatësore e tërthore mbrojtëse apo kanë seksione të sistemuara, zona, distanca dhe gjerësia e bregut është hapësira tokësore me ose pa ujë që krijohet ndërmjet argjinaturave, strukturave mbrojtëse, seksioneve të sistemuara dhe vijës ujore” dhe referuar koordinatave të pasqyruara në hartën topografike, rezulton se sipërfaqja që do të jepet në përdorim **ndodhet jashtë bregut të lumit në një largësi minimale 376 m distance nga skaji i sipërfaqes me bregun e lumit**. Koordinatat që pasqyrojnë “brigjet e lumit” dhe “sipërfaqen që do të jepet në përdorim” paraqiten në hartën (bashkëlidhur). Kështu krahasojmë sipas legjendës së hartës. Sipërfaqja që



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

do të jepet me qira është e mbrojtur me argjaturë dhe ndodhet jashtë bregut. Bazuar në sa mësipër, propozojmë miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes prej 0.442 ha, për Agropylltari, në Ekonominë Pyjore Drin Gjadër Kir, ngastra nr.14.

Bashkëlidhur po ju dërgojmë dokumentacionin e plotë, hartën e ekonomise, hartën topografike, raportit mbi studimin tekniko-ekonomik.

Duke ju falënderuar, ju ftojme në miratimin e projekt vendimit.

Grupi i Punes

Ing.Mark SULLI

Ing.Zeqir UJKA

Miratoi

Drejtori

Vehbi SHKJAU



Bashkia Vau Dejës

Shtojca nr. 1

RAPORT

**MBI STUDIMIN TEKNIKO-EKONOMIK PËR DHËNIE NË PËRDORIM
NGA FONDI PYJOR TË SIPËRFAQEVE NË PRONËSI PUBLIKE TË BASHKISË
VAU DEJËS PËR PARK FOTOVOLTAIK (STACIONET, OBJEKTET PËRKATËSE
ETJ.)**

Bazuar në Urdhërin nr.36, datë 16.01.2024 të Kryetarit të Bashkisë për vlerësimin tekniko-ekonomik të sipërfaqes pyjore për dhënie të fondit pyjor me qira, z. Zeqir Ujka Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Pyjeve, z. Mark Suli Specialist i Sektorit të Menaxhimit të Pyjeve, nga data 06.02.2024 deri në datën 08.02.2024 studjuan dhe realizuan verifikimin në terren dhe në regjistrin kadastral, për dhënien në përdorim të sipërfaqes pyjore **0.442** ha, për Agropylltari, në Ekonominë Pyjore Drin Gjadër Kir, në ngastrën nr.14.

Mbështetur në të dhënat e regjistrit kadastral pyjor/kullosor sipas VKM-së nr. 433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, i ndryshuar, rezulton që sipërfaqja e kërkuar që merret në përdorim të sipërfaqes pyjore **0.442** ha, për Agropylltari, në Ekonominë Pyjore Drin Gjadër Kir dhe bën pjesë në ngastrën nr.14, sipas listës së inventarit, pikës 49, shtojca 47, janë në pronësi/administrim të Bashkisë Vau Dejës.

Përshkrimi parcellar i sipërfaqes objekt studimi dhe kategoria e përdorimit të saj pasqyrohen në tabelat 1 dhe 2 të këtij raporti.

Nga verifikimi në terren rezulton kjo gjendje: (sipas hartës topografike, tabelave përkatëse bashkëlidhur).

“Brigjet” janë rripat anësore të tokës përgjatë rrjedhës së shtratit të lumit. Duke u mbështetur në Kreun III pika 6 germa “dh” e VKM-së nr. 748, datë 01.12.2022 “Për përcaktimin e zonës, distancës dhe gjerësisë së brigjeve të burimeve ujore”, që parashikon:



“dh) në lumenjtë e përrenjtë, shtretërit dhe/ose brigjet e të cilëve janë mbrojtur me argjinaturë dhe/ose strukturë gjatësore e tërthore mbrojtëse apo kanë seksione të sistemuara, zona, distanca dhe gjerësia e bregut është hapësira tokësore me ose pa ujë që krijohet ndërmjet argjinaturave, strukturave mbrojtëse, seksioneve të sistemuara dhe vijës ujore” dhe referuar koordinatave të pasqyruara në hartën topografike, rezulton se sipërfaqja që do të jepet në përdorim **ndodhet jashtë bregut të lumit në një largësi minimale 376 m distance nga skaji i sipërfaqes me bregun e lumit**. Koordinatat që pasqyrojnë “brigjet e lumit” dhe “sipërfaqen që do të jepet në përdorim” paraqiten në hartën (bashkëlidhur). Kështu krahasojmë sipas legjendës së hartës. Sipërfaqja që do të jepet me qira është e mbrojtur me argjinaturë dhe ndodhet jashtë bregut.

Ndërrhyrjet e propozuara që pasqyrohen në dokumentacionin e paraqitur, jepen në përdorim për një afat deri në 9 vjet një sipërfaqe prej 0.442 ha, për Agropylltari

Procedurat që ndiqen për dhënien në përdorim nga fondi pyjor janë të mbështetura në ligjin nr. 57 datë 30.04.2020 “Për pyjet” i ndryshuar, VKM-së nr. 748, datë 01.12.2022 “Për përcaktimin e zonës, distancës dhe gjerësisë së brigjeve të burimeve ujore”; VKM-së nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”, Udhëzimin nr. 1, datë 09.06.2016 të Ministrit të Mjedisit “Për Rregullat e procedurat e kërimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik.”.

Sipërfaqja që do të jepet në përdorim do t’i nënshtrohet procedurës së konkurimit publik sipas legjislacionit në fuqi.

Pas miratimit të raportit tekniko - ekonomik dhe akteve të tjera normative si më sipër, Kryetari i Bashkisë nxjerr urdhërin për zhvillimin e procedurës së konkurimit publik.

Tarifat e dhënies në përdorim nga fondi pyjor kullor bazohen në VKM-në nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

konkretisht shtojca nr.1, pika 5/1, si dhe bazohen në afatin kohor sipas grafikut të punimeve të miratuar nga institucioni përkatës dhe kategorinë e përdorimit.

Shuma në lekë/vit konsiston në:

1. Vlerën e përdorimit leke/ha/vit, për Agropylltari

- a) Ngastra nr. 14, **djerrë/ranishte 0.442** ha x 10,000 lekë/ha = **4,420** lekë në vit (katërmijë e katërqind e njëzet) lekë në vit.

Në total 4,420 lekë në vit (katërmijë e katërqind e njëzet) lekë në vit.

PËRPILUESIT E RAPORTIT TEKNIKO-EKONOMIK

Ing. Zeqir Ujka

Ing. Mark Suli

Konfirmoi:

KRYETARI

KRISTIAN SHKRELI

NË MUNGESË DHE ME URDHER

ZV/ KRYETARI

GJOVALIN ZEFI



Bashkia Vau Dejës

PASQYRE E PERSHKRIMIT PARCELAR (sipas regjistrit kadastral)
Për Agropylltari

Formulari nr.1

ID. Prone	Ekonomia Pyjore	Parcela	Sip.Tot. ha	Perberja grumbullit	Funksion i	Forma Qeverisjes	Mosha	K.D	Te dhena te grumbullit pyjor				Fuqia lendore		
									D mes	Lart. mes	Filizeria	Nen pylli	Kat et	Per ha	Total
SH22 00 014	Drin Gjader kire	14	11.14	Ranishte/dj erre			0	0	0	0	0	0	0	0	0

Bashkia Vau Dejës

PASQYRE E PERSHKRIMIT PARCELAR (sipas verifikimit ne terren)

Formulari 2

Për Agropylltari

ID. Prone	Ekonomia Pyjore	Parcela	Sip.Tot. ha	Perberja grumbullit	Funksion i	Forma Qeverisjes	Mosha	K.D	Te dhena te grumbullit pyjor				Fuqia lendore		
									D mes	Lart. mes	Filizeria	Nen pylli	Kat et	Per ha	Total
SH22 00 014	Drin Gjader kire	14	11.14	Ranishte/D jerre			0	0	0	0	0	0	0	0	0

PLOTESOI:

Ing.Mark Suli



Ing. Zeqir Ujka



Bashkia Vau Dejës

TABELA PERMBLEDHËSE E VLËRESIMIT FINANCIAR

Për Agropylltari

Perdorimi I territorit	Sip ha	Bashkia	Volumi ne m ³ sipas asortimenteve	Sasia	Vlera Leke /m3	Shuma I	Gjatesia e perdorimit km		Tarifa dhenje ne perdorim lek/ha/vit		Shuma II	Totali I+II
							1	2.-5	6.-10	10		
0	1	2	3		4	5	6	8	9	10	11	12
Ranishte/Inpr	0.442	V.Dejës	0	0	0	0	0	15000	13000	10000	4420	4420
Gjuetia	0	V.Dejës	0		0	0	0	0	0	0	0	0
Invest realiz	0	V.Dejës	0		0	0	0	0	0	0	0	0
Gjithsejt	0.442				0	0	0				4420	4420

Formulari nr.4

LISTA E NGASTRAVE, N/NGASTRAVE TË FONDIT PYOR DHE KULLOSOR PUBLIK QË HIQEN/JEPEN NË PËRDORIM

Për Agropylltari

Formulari 5

Nr.	ID Prone	Ekonomia Pyjore/kull osore	Ng/neng.nr.	Siperfaqe qe hiqet nga fondi pyjor/kulloror	Siperfaqja Gjatesia ne perdorim km			
					Siperfaqe qe jepet ne perdorim nga fondi pyjor/kulloror ha	Rruge km	Linje	
1	2	3	4	5	6	7	8	9
		Drin Gjader						
1	SH22.00.014	kire	14	0	0.67	0	0	0
Shuma					0.67			

PLOTESOI:

Ing.Mark Suli

Ing.Zeqir Ujka




PLAN RILEVIMI

PERGATITI:

A. IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE _____

NR. PASURISE 14-S1 VOL _____ FQ _____

SHKALLA 1:10000

INDEKSI I HARTES Ekonomia Pyjore DRIN GJADER KIR


ADRESA E PASURISE: Rrethi SHKODER F: KOSMAC

Data Pergatitjes: 07.02.2024

SIPERFAQE

S= 0.442 Ha

POROSITES:



SISTEMI I KOORDINATAVE: GAUS KRYGER

KOORDINATAT E KONTURIT:

1) X= 4651884.29 Y= 4381598.75 2) X= 4651902.66 Y= 4381642.91 3) X= 4651758.66 Y= 4381711.30 4) X= 4651758.84 Y= 4381684.28 5) X= 4651870.25 Y= 4381629.88 6) X= 4651862.58 Y= 4381608.10

Sup. Mark Suli
reg. dep. 1/16
1/16